

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar
Financial Reporting

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 19.01.2019

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Totali	100	

Problemi 1

Më poshtë janë dhënë pasqyrat e pozitës financiare të Arizona sh.a., Colorado sh.a dhe Nevada sh.a.

Pasqyrat e pozitës financiare me 31 dhjetor 2018

	Arizona sh.a	Colorado sh.a	Nevada sh.a
	€m	€m	€m
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>			
Prona, fabrika & paisjet	2,500	800	200
Investimet	<u>1,000</u>	<u>100</u>	<u>50</u>
	3,500	900	250
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>			
Stoqet	1,000	400	50
Llogaritë e arkëtueshme	600	200	20
Paraja & banka	<u>500</u>	<u>50</u>	<u>30</u>
	<u>2,100</u>	<u>650</u>	<u>100</u>
Total pasuritë	5,600	1,550	350
<i>Ekuiteti:</i>			
Kapitali aksionar prej €1 secila	1,000	600	50
Premia e aksioneve	1,000	100	10
Fitimet e mbajtura	<u>3,000</u>	<u>500</u>	<u>40</u>
	5,000	1,200	100
<i>Detyrimet afatgjata:</i>			
Kredia bankare	300	30	130
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>			
Të pagueshmet tregtare	200	300	100
Tatimi	<u>100</u>	<u>20</u>	<u>20</u>
	<u>600</u>	<u>350</u>	<u>250</u>
Total ekuiteti & detyrimet	5,600	1,550	350

Informatat shtesë në vijim janë relevante:

- (i) Arizona sh.a bleu 420 milion aksione të zakonshme në Colorado sh.a. me 1 korrik 2018. Konsiderata për blerje ishte €960m. Nga kjo shumë, €800m ishte paguar në para në datën e blerjes dhe pjesa e mbetur ishte pagesë e shtyrë deri me 1 korrik 2019. Pagesa në para ishte regjistruar në librat e Arizona sh.a-së por nuk është bërë ndonjë hyrje për të regjistruar elementin e shtyrë të çmimit të blerjes.

Me 31 dhjetor 2017, fitimet e mbajtura të Colorado sh.a-së ishin €300m. Me 1 korrik 2018, vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në Colorado sh.a ishte €200m.

Me 1 korrik 2018, vlerat e drejta të pasurive neto të Colorado sh.a-së ishin të barabarta me vlerat e tyre bartëse me përjashtim të një fabrike. Kjo fabrike kishte vlerë të drejtë prej €40m mbi vlerën bartëse në atë datë. Nuk është bërë ndonjë korigjim për të reflektuar këtë diferencë. Fabrika ka një jetë të mbetur të perdorimit prej katër viteve me 1 korrik 2018.

- (ii) Arizona sh.a bleu €20m aksione të zakonshme në Nevada sh.a me 1 janar 2017, me një kosto prej €40m të paguara në para. Në atë datë, saldo e fitimeve të mbajtura dhe premisë së aksioneve të Nevada sh.a-së ishte €30m dhe €10m respektivisht.
- (iii) Pas blerjes, Colorado sh.a shiti mallra tek Arizona sh.a për €50m. Colorado sh.a ka një marzhë të shitjeve prej 20%. Gjysma e mallrave mbeten të pashitura nga Arizona sh.a në datën e raportimit. Me 31 dhjetor 2018, Arizona sh.a ende nuk i ka paguar mallrat. Shuma është e përfshirë në të arkëtueshmet e Colorado sh.a-së dhe të pagueshmet e Arizona sh.a-së.
- (iv) Me 31 dhjetor 2018, zëri i mirë i Colorado sh.a-së është vlerësuar për dëmtim, dhe është konkluduar që një humbje nga dëmtimi prej €2m duhet të njhet.
- (v) Kosto e kapitalit të Arizona sh.a-së është 10% në vit. Faktori i skontimit për 1 vit = 0.909
- (vi) Është politikë e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues në blerje sipas vlerës së drejtë.
- (vii) Supozo që fitimet ndodhin njëtrajtësisht gjatë vitit.

Kërkohet:

Përgadite Pasqyrën e Konsoliduar të Pozitës Financiare për grupin Arizona për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

(20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 1

Struktura e grupit:

- Arizona sh.a bleu gjashtë muaj para periudhës raportuese 70% të ekuitetit në Colorado sh.a. IJK 30%.
- Arizona sh.a ka 40% të ekuitetit në Nevada sh.a, blerë dy vite më parë.

Grupi Arizona

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor 2018

	€m
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>	
Prona, fabrika & paisjet (2,500 + 800 + 35.0 (L15))	3,335.0
Zëri i mirë L11	3.5
Investimet në shoqëri L14	44.0
Pasuritë financiare (1,000 + 100 +145.5 - 945.5 - 40)	<u>260.0</u>
	3,642.5
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>	
Stoqet (1,000 + 400 - 5.0 (W7))	1,395.0
Llogaritë e arkëtueshme (600 + 200 - 50 (W8))	750.0
Paraja & banka (500 + 50)	<u>550.0</u>
	<u>2,695.0</u>
Total pasuritë	6,337.5
<i>Ekuiteti:</i>	
Kapitali aksionar	1,000.0
Premia e aksioneve	1,000.0
Fitimet e mbajtura L12	<u>3,056.8</u>
	5,056.8
Interesi jo-kontrollues L13	<u>227.9</u>
	5,284.7
<i>Detyrimet afatgjata:</i>	
Kredia bankare (300 +30)	330.0
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>	
Të pagueshmet tregtare (200 + 300 - 50 (L18))	450.0
Konsiderata e shtyrë L16	152.8
Tatimi (100 + 20)	<u>120.0</u>
	1,052.8
Total ekuiteti & detyrimet	6,337.5

L11 - Zëri i mirë në blerje e Colorado sh.a		€m
<i>Kosto e investimit:</i>		
Paraja		800.0
Konsiderata e shtyrë (L16)		<u>145.5</u>
		945.5
Vlera e IJK-së në blerje		200.0
<i>VD e neto pasurive në blerje:</i>		
Kapitali aksionar	600	
Premia e aksioneve	100	
Fitimet e mbajtura	400	
Korigjimet e vlerës së drejtë	<u>40</u>	<u>(1,140)</u>
Zëri i mirë		5.5
Humbja nga dëmtimi		<u>(2.0)</u>
Saldo ne PKPF		3.5
Fitimet e mbajtura të Colorado sh.a-së në blerje:		
Saldo me 31 dhjetor 2017		300.0
Fitimet deri me 1 korrik 2018 (500 - 300) x 6/12		<u>100.0</u>
Saldo me 31 dhjetor 2018		400.0

L12 Fitimet e mbajtura	Arizona	Colorado
	€ m	€ m
Saldo në datën e raportimit	3,000.0	500.0
Minus saldo në blerje		(400.0)
Dëmtimi i zërit të mire		(2.0)
Zhvlerësimi shtesë në korigjimin e vlerës së drejtë		(5.0)
Anulim i skontimit në konsideratën e shtyrë	(7.3)	
Pjesa e F/M të shoqërisë	4.0	
Fitimi i përealizuar nga tregtia ndërgrupore	<u>(5.0)</u>	<u> </u>
	2,991.7	93.0
Pjesa e grupit (70% x 93.0)	<u>65.1</u>	
Saldo ne PPF	3,056.8	

L13 - Interesi jo-kontrollues në Colorado sh.a	€ m
VD në blerje	200.0
Pjesa e F/M të Colorado (30% x 93)	<u>27.9</u>
Saldo ne PPF	227.9

L14 - Investimet në shoqëri (Nevada)	€ m
Kosto e investimit	40.0
Pjesa e fitimeve të mbajtura pas blerjes (40 - 30) x 40%	<u>4.0</u>
Saldo ne PPF	44.0

L15 - Korigjimi i vlerës së drejtë	€ m
Mbi vlerën e drejtë në blerje	40.0
Zhvlerësimi shtesë që nga blerja 40/4 vite x 6/12	<u>(5.0)</u>
Saldo ne PPF	35.0
L16 - Konsiderata e shtyrë	€ m
Shuma e konsideratës së shtyrë	160.0
Vlera e tanishme 160 / 1.1	145.5
Anulim i skontimi (Shpenzimet e interesit) $145.4 \times 10\% \times 6/12 =$	<u>7.3</u>
Detyrimi në datën e raportimi	152.8
L17 - tregtia ndërgrupore	€ m
Total fitimi në tregtim (50 - 40)	10.0
Mallrat ende në stoqe	<u>50%</u>
Fitimi i porealizuar	5.0
L18 - Saldo ndërgrupore tregtare	€ m
Zvogëlo të arkëtueshmet dhe të pagueshmet tregtare për	50

Problemi 2

a) Me 1 janar 2018 Colorado sh.a emetoi një 4% obligacion në shume prej €10m i cili është i konvetrueshëm në maturitet në opcion të mbajtësit në 1 milion aksione të Colorado sh.a. Ky obligacion është i ripagueshem në vlerë nominale me 31 dhjetor 2021 dhe interesi vjetor paguhet në fund të çdo viti. Normat që mbizotëruan në treg për obligacionin e njetë pa opcion të konvertimit ishin 6%.

Faktorët e skontimit janë si në vijim:

Viti	4%	6%
1	0.9615	0.9434
2	0.9246	0.8910
3	0.8891	0.8396
4	0.8548	0.7921

Kërkohet:

- i) **Shpjego shkurtimisht kriteret e njohjes dhe ç'njohjes të përshkruara nga SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja.** (5 pikë)
- ii) **Llogariti vlerat e obligacionit të emetuar për njohjen fillestare dhe matjen pasuese me 31 dhjetor 2018.** (5 pikë)

b) New York sh.p.k është një kompani që shet katër artikuj A, B, C dhe D. Detajet e stoqeve të pashitura të kompanisë me 31 dhjetor 2018 janë si në vijim:

Artikulli	Nr. i njesive	Kosto për njesi €	Vlera neto e realizueshme për njesi €
A	10	700	1,500
B	5	1,500	3,000
C	8	400	300
D	2	800	1,500

Kërkohet:

Llogarite vlerën e stoqeve mësipër me 31 dhjetor 2018 siq kërkohet nga SNK 2 Stoqet. (5 pikë)

c) Me 15 nëntor 2018, New Jersey sh.p.k bleu pesë njësi të stoqeve për €1,000 secila. Përveç kësaj, New Jersey sh.p.k pagoi tarifë doganore prej €500 dhe transportin prej €300. Me 31 dhjetor 2018 asnjëra nga njesitë nuk është shitur. Në këtë datë çmimi shitës për njësi i stoqeve ishte €1,200 për njësi. Kosto e vlerësuar për të realizuar shitjen e të gjitha njesive është €500.

Kërkohet:

Llogarite vlerën e stoqeve siq kërkohet nga SNK 2 Stoqet për njesitë e mësipërme që duhet të përfshihet në pasqyrën e pozitës financiare dhe pasqyrën e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. (5 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 2

2.

i) Kriteret e njohjes dhe ç'njohjes së një pasurie financiare

SNK 39 Kërkon njohjen e një pasurie financiare atëhere dhe vetëm atëhere, kur entiteti bëhet palë kontraktuale e instrumentit.

Një pasuri financiare ç'njihet dhe larhohet nga pasqyra e pozitës financiare kur të drejtat kontraktuale për rrjedhat e parasë nga pasuria financiare marturojnë apo pasuria financiare transferohet (p.sh. entiteti transferon të drejtat kontraktuale për të pranuar rrjedhat e parasë para ose entiteti mban të drejtat për t'i pranuar rrjedhat e parasë por gjithashtu merr përsipër detyrime kontraktuale për t'i kaluar ato rrjedha të parasë tek një entitet tjetër dhe nëse kushtet e caktuara përmbushen).

ii) Vlera e tanishme e 4% obligacionit në datën e emetimi:

Njohja fillestare '000

Viti	Interesi (4%)	Kryegjëja	Faktori i skontimit (6%)	Vlera e tanishme
	€	€		€
2018	400		0.9434	377.36
2019	400		0.8910	356.40
2020	400		0.8396	335.84
2021	400	10,000	0.7921	<u>8,237.84</u>
VNT				9,307.44

Detyrimi 9,307.44

Ekuiteti (10,000 - 9,307.44) 692.56

Matja pasuese: kosto e amortizuar duke përdorur normen efektive të interes (NEI):

'000

Viti	Saldo fillim	NEI 6%	Interesi i paguar	Saldo fund
	€	€	€	€
2017	9,307.44	558.44*	400	9,465.87

* Rrumbullakësuar

b) Vlera e stoqeve në fund me 31 dhjetor 2018. (më e ulëta e kostos apo VNR)

	Nr. i njesive	Kosto/njesi (€)	VNR/njesi (€)	Stoqet në fund(€)
A	10	700	1,500	7,000
B	5	1,500	3,000	7,500
C	8	400	300	2,400
D	2	800	<u>1,500</u>	<u>1,600</u>
				18,500

c) Vlera e stoqeve me 31 dhjetor 2018

<i>Kosto:</i>	€
Kosto e blerjes (€1,000 x 5)	5,000
Tarifa doganore	500
Transporti	<u>300</u>
	5,800
<i>Vlera neto e realizueshme:</i>	
Çmimi shitës për njesi (€1,200 x 5)	6,000
Kosto e vleresuar për të realizuar shitjen	<u>(500)</u>
	5,500

Stoqet duhet të maten sipas kostos apo vleres neto të realizueshme cilado që ëshë më e ulët. Andaj, stoqet duhet të maten €5,500.

Problemi 3

Bilanci vërtetues në vijim i datës 31 dhjetor 2018 është i New Mexico sh.p.k një prodhues i tekstilit.

	Debi	Kredi
	€'000	€'000
Kosto e shpërndarjes	20,000	
Shpenzimet administrative	30,000	
Banka	25,000	
Të arkëtueshmet tregtare	40,000	
Interesi në kredi	2,000	
Kosto e shitjes	170,000	
Shpenzimet e zhvillimit	16,000	
Tatimi i paguar gjatë vitit	10,000	
Dividenda e paguar	6,000	
Stoqet me 31 dhjetor 2018	36,000	
Toka me 1 janar 2018	50,000	
Ndërtesa sipas koston me 1 janar 2018	30,000	
Fabrika & paisjet sipas koston me 1 janar 2018	50,000	
Zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2018:		
- Ndërtesat		15,000
- Fabrika & paisjet		17,000
Kapitali aksionar		30,000
Fitimet e mbajtura me 1 janar 2018		45,000
10% Kredi bankare		20,000
Të ardhurat		300,000
Të hyrat nga investimet		1,000
Provizionet për gjyq		2,000
Tatimi i shtyrë		4,000
Tatimi i pagueshëm me 1 janar 2018		1,000
Të pagueshmet tregtare		50,000
	<u>485,000</u>	<u>485,000</u>

Informata shitesë:

i) Toka është rivlerësuar me 31 dhjetor 2018 nga një vlerësues i pavarur në €55,000,000.

Toka më heret ishte rivlerësuar në vitin 2017 që rezultoi në një rënie në vlerë prej €2,000,000. Renia në vlerë ishte njohur në pasqyrën e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017.

ii) Me 1 janar 2018, një ndërtesë e cila kishte vlerë të bartur prej €3,000,000 (kosto €5,000,000) ishte riklasifikuar si "pasuri jo-qarkulluese e mbajtur për shitje". Vlera e drejtë minus kosto e shitjes ishte €2,800,000. Nuk është bërë asnjë korigjim për të regjistruar riklasifikimin.

- iii) Një paisje që ishte blerë para pesë viteve pati disa probleme teknike dhe si rezultat gjatë vitit një komponentë e rëndësishme që kushtoi €500,000 ishte zëvendësuar me një komponentë të re e cila kushtoi €1,000,000. Zëvendësimi rriti kapacitetin operues. Komponenta e vjetër u shit për €150,000 në para. Asnjë nga këto korigjime nuk është bërë në libra gjatë vitit.

Fabrika dhe paisjet kanë një jetë të përdorimit prej dhjetë viteve ndërsa ndërtesat kanë një jetë të vlerësuar të përdorimit prej dyzet viteve. Zhvlerësimi për tërë vitin ngarkohet në vitin e blerjes ndërsa nuk ngarkohet zhvlerësim në vitin e heqjes/largimit. Zhvlerësimi dhe amortizimi i ngarkohen shpenzimeve administrative.

- iv) Një paisje speciale e cila është përdorur për të prodhuar një produkt të quajtur 'Star' ishte blerë me 1 janar 2017 për €2,000,000. Gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2018, kërkesa për këtë produkt kanë rënë mjaft shumë. Prandaj, vlera e rikuperueshme e paisjes me 31 dhjetor 2018 ishte €1,000,000. Kompania vendosi të regjistroj në humbje nga dëmtimi gjatë vitit financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2018.
- v) Vetem 70% e shpenzimeve të zhvillimit e përmbushin kriterin për kapitalizim. Shpenzimi ka të bëjë me një produkt i cili u fut në treg me 1 korrik 2017. Pritet që të gëzojë përfitime ekonomike për katër vite.
- vi) Shpenzimi i tatimit për vitin ishte €8,000,000. Kjo shumë nuk përfshin rritjen në tatimin e shtyrë. Tatimi i shtyrë me 31 dhjetor 2018 është €5,000,000.

Kërkohet:

Përgaditë një pasqyrë të të ardhurave dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse dhe një pasqyrë të pozitës financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 për New Mexico sh.p.k (Injoro fitimin për aksion)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 3

New Mexico sh.p.k

Pasqyra e të ardhurave dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për VP me 31 dhjetor 2018

	€'000
Të ardhurat	300,000
Kosto e shitjes	<u>(170,000)</u>
Fitimi bruto	130,000
Të hyrat nga investimet	1,000
Humbja nga shitja [150 - (500 - (500 x 10% x 5y)]	(100)
Rikuperimi i rëniës së mëhershme në vlerë të tokës	2,000
Humbja nga dëmtimi i PJQMSH (3,000 - 2,800)	(200)
Kosto e shpërndarjes	(20,000)
Shpenzimet administrative (II2)	(43,875)
Kosto financiare	<u>(2,000)</u>
Fitimi para tatimit	66,825
Tatimi (8,000 + 1,000)	<u>(9,000)</u>
Fitimi i vitit	57,825
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:	
Teprica në rivlerësimin e tokës (5,000 - 2,000)	<u>3,000</u>
Total Të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	60,825

New Mexico sh.p.k

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2018

	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Prona, fabrika & paisjet (L1)	94,475
Pasuritë e paprekshme (16,000 - 4,800 - 1,400 - 2,800)	7,000
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet	36,000
Të arkëtueshmet tregtare	40,000
Tatimi i rikuperueshëm (10,000 - 1,000 - 8,000)	1,000
Banka (25,000 - 1,000 + 150)	24,150
Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje	<u>2,800</u>
	205,425
<i>Ekuiteti</i>	
Kapitali aksionar	30,000
Fitimet e mbajtura (II3)	95,425
Teprica e rivlerësimitn (II3)	<u>3,000</u>
Ekuiteti i pronarve	128,425
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
10% Kredi bankare	20,000
Tatimi i shtyrë	5,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
Të pagueshmet tregtare	50,000
Provizionet për gjyq (2,000)	<u>2,000</u>
	205,425

II1**Prona, fabrika & paisjet €'000**

<i>Kosto/Vlerësimi:</i>	Toka	Ndërtesa	Fabrika & paisjet	Total
Sal. me 1 janar 2018	50,000	30,000	50,000	130,000
Rivlerësimi	5,000	-	-	5,000
Shitjet	-	-	(500)	(500)
Blerjet	-	-	1,000	1,000
Transfer te PJQMSH		<u>(5,000)</u>	<u>-</u>	<u>(5,000)</u>
Sal. me 31 dhjetor 2018	55,000	25,000	50,500	130,500
<i>Zhvlerësimi i akumuluar:</i>				
Sal. me 1 janar 2018	-	15,000	17,000	32,000
Shitjet	-	-	(250)	(250)
Transfer te PJQMSH		(2,000)		(2,000)
Zhvl. aktual	<u>-</u>	<u>625</u>	<u>5,050</u>	<u>5,675</u>
Sal. me 31 dhjetor 2018	-	13,625	21,800	35,425
<i>Dëmtimi i akumuluar:</i>				
Sal. me 1 janar 2018	-	-	-	
Viti aktual	-	-	<u>600</u>	<u>600</u>
Sal. me 31 dhjetor 2018	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>600</u>	<u>600</u>
Vlera bartese	55,000	11,375	28,250	94,475

II2

Shpenzimet administrative	€'000
Sipas bilancit provues	30,000
Zhvlerësimi (625 + 5,050)	5,675
Amortizimi i shp. Zhv. (70% x 16,000/4y)	2,800
Dëmtimi i makinerisë (2,000 - (2,000 /10 x 2y) - 1,000)	600
Shpenzimet e zhvillimit (30% x 16,000)	<u>4,800</u>
Total	43,875

II3

	Fitimet e mbajtura	Teprica e rivlerësimit
	€'000	€'000
1 janar 2018	45,000	-
Korigj. i mepar. amort. i shp zhvl. (70% x 16,000/4 x 1/2)	(1,400)	
Fitimi pas tatimit	57,825	
Teprica në rivlerësimin e tokës		3,000
Dividenda e paguar	<u>(6,000)</u>	
Saldo me 31 dhjetor 2018	95,425	3,000

Problemi 4

a) Maine sh.p.k së fundi ndryshoi planin e tij të prodhimit gjë që rezultoi me ndryshim të përdorimit të një makinerie e cila kishte vlerë bartëse (pas zhvlerësimit të vitit) prej €10 milion me 31 dhjetor 2018. Për shkak të ndryshimit të përdorimit, makineria mund të jetë dëmtuar. Me 31 dhjetor 2018, vlera e saj e drejtë minus kostot e shitjes ishte €9.2 milion. Pas ndryshimit në përdorim, makineria tani pritet të gjeneroj rrjedha neto vjetore të parasë prej €3 milion në fund të tre viteve të ardhshme dhe do të shitet për €2 milion në fund të kësaj periudhe. Norma e skontimit e kompanisë 10%.

Normat e skontimit

Viti	10%
1	0.909
2	0.826
3	0.751

Kërkohet:

Shpjego trajtimin e kërkuar në kontabilitet nga SNK 36 *Dëmtimi i pasurive* për dëmtimin e makinerisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. Ju duhet t'i paraqitni llogaritjet përkatëse dhe t'i tregoni hyrjet në kontabilitet nëse ka ndonjë. (5 pikë)

b) Me 1 janar 2018, Virginia sh.p.k hyri në një kontratë të lizingut me West Virginia Ltd për një makineri të specializuar të prodhimit. Çmimi në para për makinerinë ishte €772,000 dhe Virginia sh.p.k u pajtua të bëj tri pagesa vjetore prej €200,000 në fillim të vitit duke fillua me 1 janar 2018 dhe një pagesë të fundit prej €300,000 në fund të kontratës pas tre viteve. Sipas kushteve të lizingut, Virginia sh.p.k do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen e makinerisë dhe ka një opcion të blejë makinerinë për një shumë nominale në fund të lizingut. Lizingu nuk ka mundësi të ndërprerjes. Jeta e prituri e pasurisë është tre vite pas së cilës to të ketë zero vlerë të mbëtur. Norma e interesit e nënkuptuar në lizing është 10%. Normat e skontimit janë dhënë në pjesën a) më sipër.

Kërkohet:

Shpjego trajtimin në kontabilitet të kërkuar nga SNK 17 *Lizingjet* për kontratën e mësipërme. Ju duhet të paraqitni llogaritjet përkatëse dhe ekstraktet për pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e pozitës financiare për Virginia sh.p.k për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. (5 pikë)

c)

Idaho sh.p.k shiti produkte në pako klientëve të saj për €4m në para me 1 tetor 2018. Pakoja përbëhej nga paisja (me një çmim normal të shitjes me pakicë prej €3.25m) dhe dymbëdhjetë muaj të mbështetjes online (me një çmim normal të shitjes me pakicë prej €1.75m). Të hyrat prej €4m janë njohur në draft pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018.

Kërkohet:

Shpjego trajtimin në kontabilitet të kërkuar nga SNK 18 *Të hyrat* për shitjet e mësipërme. Ju duhet t'i paraqitni llogaritjet dhe ekstraktet nga pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyra e pozitës financiare të Idaho sh.p.k-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018.

(5 pikë)

d) Mississippi sh.a mban një portfolio të investimeve në ekuitet me vlerë prej €10m me 1 janar 2018. Gjatë vitit të përfunduar 31 dhjetor 2018, kompania pranoi dividend prej €10m.

Gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2018 u blenë edhe investime tjera në ekuitet me kosto prej €2m. Disa investimet në ekuitet u shiten gjatë vitit për €1.5m. Këto investime në ekuitet kishin kushtuar €1m disa vite më parë por ishin vlerësuar në €1.3m on 1 janar 2018. Vlera e drejtë e investimeve në ekuitet të mbajtura me 31 dhjetor 2018 ishte €12m.

Mississippi sh.a klasifikon investimet në ekuitet si të mbajtura për shitje siç lejohet nga SNK 39 *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*.

Kërkohet:

Shpjego shkurtimisht trajtimin e duhur në kontabilitet dhe trego hyrjet në ditar në pasqyrat financiare të Mississippi sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. Çdo hyrje që afekton pasqyrën e të ardhurave apo pasqyrën e të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse duhet të tregohet qartë si 'pasqyra e të ardhurave' apo 'pasqyra e të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse. (5 pikë)

(20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 4

a)

Sipas SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*, makineria duhet të testohet për dëmtim.

	€m
Vlera bartëse	10
Shuma e rikuperueshme	<u>(9.2)</u>
Dëmtimi	0.8

Vlera në përdorim ((€3m x 2.486) + (€2m x 0.751) = €8.96m

Vlera e drejtë minus kosto e shitjes = €9.2m

Shuma e rikuperueshme është më e larta e vlerës në përdorim(€8.96m) dhe vlerës së drejtë minus kosto e shitjes (€9.2m)

	€m	€m
D PAGJ	0.8	
K (PFP)		0.8

b)

Lizingu me West Virginia sh.p.k duhet të trajtohet si një lizing financiar pasi që i përmbush treguesit e mëposhtëm të lizingut financiar sipas SNK 17 *Lizingjet*:

- kohezgjatja e lizingut është për pjesën më të madhe të jetës ekonomike të pasurisë.
- në fillim të lizingut vlera e tanishme e pagesave minimale të lizingut është pothuajse e barabartë me vlerën e drejtë të pasurisë.

	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3
	€m	€m	€m	€m
Pagesa	0.200	0.200	0.200	0.300
Faktori i skontimit 10%	<u>1</u>	<u>0.909</u>	<u>0.826</u>	<u>0.751</u>
Vlera e tanishme	0.200	0.182	0.165	0.225
Total vlera e tanishme = 0.772				

- Virginia sh.p.k ka opcionin e blerjes së makinerisë për një shumë nominale në fund të lizingut.

Virginia sh.p.k duhet ta njohë makinerinë si një pasuri dhe një detyrim të barabartë me vlerën e drejtë të makinerisë. Kosto e financimit më pas duhet të alokohet në çdo periudhë duke siguruar një normë konstante periodike të interes, që në këtë rast është 10%. Zhvlerësimi duhet të ngarkohet në makinerinë në pajtim me SNK 16 *Prona, fabrika dhe paisjet*.

Llogaritja e interes vjetor përgjatë viteve është si më poshtë:

Viti	Saldo fillim	Pagesa	Saldo për int.	Interesi	Saldo fund	Detyrim shkurtë	Afat-gjatë
	€m	€m	€m	€m	€m	€m	€m
31 dhjetor 18	0.772	0.2	0.572	0.0572	0.6292	0.2	0.4292
31 dhjetor 19	0.6292	0.2	0.4292	0.0429	0.4721	0.2	0.2721
31 dhjetor 20	0.4721	0.2	0.2721	0.0272	0.2993	0.2993	0
31 dhjetor 21	0.2993*	0.3*	0				

*Diferencat për shkak të rrumbullakësimit

Zhvlerësimi do të ngarkohet përgjatë kohezgjatjes së lizingut ose jetës së përdorimit të pasurisë cilado që është më e ulët, në këtë rast tre vite.

	€m
Kosto	0.772
Zhvlerësimi	<u>0.258</u>
Vlera neto në libra 31 dhjetor 18	0.514
Ekstraktet	
PA për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018	
Zhvlerësimi	0.258
Kosto financiare	0.0572
PPF	
Prona, fabrika dhe paisjet	0.514
Detyrimi i lizingut financiar <1 vit	0.2
Detyrimi i lizingut financiar >1 vit	0.4292

c)

Kur shiten në pako mallrat dhe shërbimet atëherë komponentët e pakos duhet të identifikohen, maten dhe njihen sikur të jenë shitur ndarazi. Nëse totali i vlerës së drejtë tejkalon çmimin në total atëherë qasja e duhur do të ishte që të aplikohet norma e njëjtë e përqindjes së zbritjes për secilin komponentë. Në këtë rast çmimi i pakos është (€4m) me 20% zbritje ndaj vlerave të drejta të komponentëve ndarazi (€3.25m + €1.75m). Andaj dy komponentët e transaksionit duhet të kontabilizohen si në vijim:

- Paisja - të hyra prej €2.6m (80% e €3.25m) të njihet menjëherë
- Mbështetja online - të hyra prej €1.4m (80% x €1.75m) duhet të njihet sipas shkallës së kompletimit.

Ekstraktet	Viti 2018
PAGJ	€m
Të hyrat 2.6 + (1.4/12x3)	2.95
PPF	
Të hyrat e shtyera (1.4/12x9)	1.05

d)

Dividendat e pranuar njihen si të hyra pa marrë parasysh klasifikimin e investimeve në ekuitet

<i>Dividenda e pranuar</i>	€m	€m
----------------------------	-----------	-----------

D Paraja	1	
K Pasqyra e të ardhurave		1

<i>Blerja e investimeve në ekuitet</i>	€m	€m
--	-----------	-----------

D Investimet në ekuitet	2	
K Paraja		2

Ri-matjet njihen në pajtim me politiken e Mississippi sh.a.

<i>Ri-matja dhe shitja</i>	€m	€m
----------------------------	-----------	-----------

D Investimet në ekuitet (1.5m – 1.3m)	0.2	
K Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		0.2

D Paraja	1.5	
K Investimet në ekuitet		1.5

Investimet në ekuitet të mbajtura në fund të periudhës duhet të rimaten në €12 milion. Këto veq se kanë vlerë bartëse prej €10.7 milion (€12m në fillim – €1.3m shitur + €2m blerje). Vlera e drejtë e këtyre investimeve në ekuitet të mbetura me 31 dhjetor 2018 ishte €12 milion, andaj një fitim prej €1.3 milion (€12m – €10.7m) duhet të njihet.

<i>Ri-matja me 31 dhjetor 2018</i>	€m	€m
------------------------------------	-----------	-----------

D Investimet në ekuitet	1.3	
K Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		1.3

Problemi 5

Më poshtë janë dhënë pasqyrat financiare të Indiana sh.p.k:

Pasqyra e të Ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018

	€'000
Të hyrat	50,000
Kosto e shitjeve dhe shpenzimet	<u>(35,000)</u>
Fitimi operativ	15,000
Kosto e shpërndarjes	(4,000)
Shpenzimet administrative	<u>(9,000)</u>
Fitimi nga operacionet	2,200
Kosto financiare	<u>(200)</u>
Fitimi para tatimit	2,000
Shpenzimet e tatimit në fitim	<u>(600)</u>
Fitimi për vitin	1,400

Pasqyrat e Pozitës Financiare me 31 dhjetor

	2018		2017	
	€'000	€'000	€'000	€'000
Pasuritë				
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>				
Shpenzimet e zhvillimit		4,100		4,000
Prona, fabrika dhe paisjet		<u>16,000</u>		<u>17,000</u>
		20,100		21,000
<i>Pasuritë qarkulluese</i>				
Stoqet	2,800		2,500	
Të arkëtueshmet tregtare	2,200		1,800	
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	<u>1,400</u>		<u>1,000</u>	
		<u>6,400</u>		<u>5,300</u>
Total Pasuritë		26,500		26,300
Ekuiteti dhe detyrimet				
Aksionet e zakonshme prej €0.20 secila		10,000		8,000
Premia e aksioneve		5,000		2,000
Teprica e rivlerësimit		1,500		1,000
Fitimet e mbajtura		<u>5,000</u>		<u>4,500</u>
		21,500		15,500
<i>Detyrimet afatgjata</i>				
5% Notë krediti	2,000		7,000	
Tatimi i shtyrë	<u>800</u>		<u>500</u>	
		2,800		7,500
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>				
Të pagueshmet tregtare	1,800		1,400	
Tatimi i pagueshëm	200		1,000	
Shpenzimet akruale	<u>200</u>	<u>2,200</u>	<u>900</u>	<u>3,300</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet		26,500		26,300

Informata shtesë:

- i) Gjatë vitit, Indiana sh.p.k shiti në para një zë të pronës, fabrikës dhe paisjeve me vlerë bartëse prej €200,000 për €290,000. Fitimi nga shitja është përfshirë në koston e shitjeve.

Kosto e shitjeve gjithashtu përfshijnë €300,000 të amortizimit të kostove të zhvillimit gjatë vitit.
- ii) Shpenzimi i zhvlërimit gjatë vitit ishte €3,000,000 i përfshirë gjithashtu në koston e shitjes.
- iii) Saldo e shpenzimeve akruale përfshin interesin e pagueshëm prej €500,000 me 31 dhjetor 2017 dhe €50,000 me 31 dhjetor 2018.

Kërkohet:

Në pajtim me kërkesat e SNK 7 Pasqyra e Rrjedhave të Parasë përgadite Pasqyrën e Rrjedhave të Parasë të Indiana sh.p.k-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. (20 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e Problemit 5

Indiana sh.p.k

Pasqyra e Rrjedhave të Parasë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018

	€'000	€'000
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitimi para tatimit		2,000
Zhvlerësimi		3,000
Amortizimi i shpenzimeve të zhvillimit		300
Shpenzimet e interesit		200
Fitimi nga shitja e pronës, fabrikës dhe pasisjeve (290-200)		(90)
Rritja në stoqe (2,800-2,500)	(300)	
Rritja në të arkëtueshmet (2,200-1,800)	(400)	
Rritja në të pagueshmet (1,800-1,400)	400	
Zvogëlimi në shpenzimet akruale ((200-50)-(900-500))	<u>(250)</u>	<u>(550)</u>
<i>Paraja e gjeneruar nga operacionet</i>		4,860
Interesi i paguar (50-200-500)	(650)	
Tatimi i paguar (500-800-600-1,800+1,400)	(1,100)	<u>(1,750)</u>
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		3,110
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</i>		
Blerja e pronës, fabrikës dhe pasisjeve (I1)	(1,700)	
Zhpenzimet e zhvillimit (I2)	(400)	
Arkëtimet nga shitja e pronës, fabrikës dhe pasisjeve	<u>290</u>	
Neto Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		(1,810)
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</i>		
Arkëtimi nga emetimi i aksioneve (10,000+5,000-8,000-2,000)	5,000	
Dividenda e paguar (4,500+1,400-5,000)	(900)	
Pagesa e 5% notë krediti (2,000-7,000)	<u>(5,000)</u>	
Neto Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		(900)
Neto paraja dhe ekuivalentët e parasë		400
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim		1,000
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund		1,400

Llogaritjet

1 Prona, fabrika dhe pasijet

	€'000		€'000
Saldo në fillim	17,000	Shitja	200
Rivlerësimi	500	Zhvlërësimi	3,000
Paraja (shif. bal)	<u>1,700</u>	Saldo në fund	<u>16,000</u>
	19,200		19,200

2 Shpenzimet e zhvillimit

	€'000		€'000
Saldo në fillim	4,000	Amortizimi	300
Para (blerjet)	<u>400</u>	Saldo në fund	<u>4,100</u>
	4,400		4,400